



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04
Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 5 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Ndryshim të Afatit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 39(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 9(5)(a) dhe (6) dhe 97(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerrë këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 21 qershor 2021, gjatë konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes,² Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një urdhër gojor për zgjatjen e afateve, përkatësisht: (i) deri më 12 korrik 2021 për parashtrimin e mocioneve paraprake të Mbrojtjes së z. Shala (“Mbrojtja”); (ii) deri më 13 gusht 2021 për parashtrimin e përgjigjes së Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS” dhe “Përgjigja”); dhe (iii) deri më 30 gusht 2021 për parashtrimin e kundërpërgjigjes së Mbrojtjes (“Kundërpërgjigja”).³

2. Më 2 korrik 2021, ZPS-ja parashtrroi kërkesë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e Përgjigjes deri më 6 shtator 2021 (“Kërkesa”), duke pasur parasysh afatet ekzistuese për nxjerrjen e materialeve në këtë çështje dhe në çështje gjyqësore të ngjashme gjatë periudhës së pushimit të Gjykatës, dhe numrin e punonjësve dhe burimeve të disponueshme si pasojë e periudhës së pushimit të Gjykatës.⁴ ZPS-ja më tej parashtron se nuk kundërshton nëse Mbrojtjes i miratohet zgjatje e ngjashme e afatit për dorëzimin e Kundërpërgjigjes deri më 24 shtator 2021, dhe se Mbrojtja ka konfirmuar se nuk kundërshton ndryshimin e propozuar të afateve.⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Paraqitjen e Parashtrimeve*, 7 qershor 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021, faqe 62, rreshtat 12-18.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00051, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Ndryshim të Afatit për Mocionet Paraprake*, 2 korrik 2021, publike, para. 2.

⁵ Kërkesa, para. 2.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Panelit.

4. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret pa i dhënë atyre mundësinë për të shprehur mendimin.

III. DISKUTIM

5. Megjithëse ZPS-ja ishte në dijeni të afateve ekzistuese,⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se janë paraqitur arsye bindëse që përligjin ndryshimin e kërkuar të afatit për dorëzimin e Përgjigjes, duke qenë se ndikimi i plotë i këtyre afateve u bë i qartë vetëm pas konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon ZPS-në të dorëzojë Përgjigjen e vet jo më vonë se 6 shtatori 2021. Si rezultat i ndryshimit të këtij afati zgjatet edhe afati për dorëzimin e Kundërpërgjigjes së Mbrojtjes deri në 24 shtator 2021.

6. Duke pasur parasysh se gjatë komunikimeve *inter partes* Mbrojtja ka bërë të ditur se nuk kundërshton ndryshimin e afateve të propozuar nga ZPS-ja, Mbrojtjes nuk i është shkaktuar padrejtësi me lëshimin e këtij vendimi pa marrjen e përgjigjes së saj ndaj Kërkesës.

⁶ Kërkesa, poshtëshënimi 3.

